

Raport për rezultatet e konsultimeve publike për:

Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar”

1. Titulli i projektaktit

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar”.

Objektivat të cilat synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji, kanë të bëjnë me miradministrimin dhe përdorimin sa më eficient, efektiv dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara, jo vetëm nga aktet e organeve të drejtësisë, por edhe të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga akte të organeve administrative, pushtetit vendor, siç janë edhe ndërtimet pa leje, duke mundësuar rikthimin në komunitet të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme.

Këto qëllime dhe objektiva synojnë të krijojnë një sistem më të mirë administrimi të pasurive të sekuestruara/konfiskuara, duke forcuar mbrojtjen e interesave publike dhe kthimin në komunitet në mënyra të ndryshme të përfitimeve të arritura.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Në hartimin e këtij projektakti, morën pjesë përfaqësues nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Projektligji iu nënshtrua procesit të konsultimit publik nëpërmjet publikimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, për një periudhë prej 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 19.12.2025 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJKP, të gjitha palët e interesuara:

- organet publike;
- shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
- personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe
- personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë,

ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin.

Projektakti u konsultua së bashku me dokumentacionin shoqërues, tw publikuar në RENJKP, prej datës 19.12.2025 deri në datë 21.1.2026, duke regjistruar 683 shikime dhe 0 komente.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metoda e konsultimit, e përdorur për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në në ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar”, është si më poshtë:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit. Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Nuk rezulton të ketë patur palë të interesuara (organizata të shoqërisë civile, subjekte private apo individë), të përfshira në procesin e konsultimit publik të projekt aktit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nuk pati komente apo sugjerime lidhur me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 34/2019, “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar”, të publikuar në RENJK.

Çështja e adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi	Justifikimi
(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	(grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	(Pranuar/P ranuar pjesërisht/ Refuzuar)	